

**KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI**

MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

ndërmjet

Komunës së Gjilanit si autoritet publik

dhe

Besa Neziri nga Gjilani, përfituese

Gjilan, 2023

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje është subvencionimi i Besa Nezirit nga Gjilanit, për dizajnin e librit "Pranvera e Luleve të Kuqe" nga Nuhi Berisha.
2. Marrëveshja është lidhur sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/2018, 01 nr. 016-28468 dt. 22. 03.2018 (neni 13 dhe neni 22 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7)

Neni 2
Vlera e Subvencionimit

Vlera e subvencionimit sipas nenit 1 paragrafi 1 të kësaj marrëveshje është **250 €** (dyqindpesëdhjetë euro) dhe pagesa bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3
Obligimet e palëve

1. Obligimet e përfitueses së subvencionit janë:

1.1. Mjetet e marra përfituesja do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet siç u cekë më lartë.

1.2. Përfituesja duhet të raportoj tek Komuna e Gjilanit.

Neni 4

1. Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:

1.1. Obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje t'ia transferoj në xhirollogarinë bankare të përfitueses, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;

1.2. Bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.

2. Komuna e Gjilanit mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

Neni 5
Afatet kohore

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.
2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 6
Kthimi i mjeteve

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve, përfituesja është e obliguar t'i kthejë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

Neni 9


Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta ku secila palë do të marrë nga një kopje.

Komuna e Gjilanit

Alban Hyseni, Kryetar



Besa Neziri



REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT

OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **250 (dyqindpesëdhjetë euro)** për Besa Nezirin për dizajnin e librit "Pranvera e Luleve të Kuqe" nga Nuhi Berisha.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Mjetet derdhen në xhirollogarinë e përfitueses nr. [REDACTED]
4. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim e përfitueses.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dorëzohet:

- Palës.
- DB, DKRS dhe
- Arkivit.

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni

